LIGJ
Nr.9819, datë 25.10.2007

PËR RATIFIKIMIN E "MARRËVESHJES NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS SË ARGJENTINËS PËR BASHKËPUNIMIN SHKENCOR DHE TEKNIK"

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet "Marrëveshja ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Argjentinës për bashkëpunimin shkencor dhe teknik".

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.5498, datë 1.11.2007 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bamir Topi

MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI SHKENCOR DHE TEKNIK

NDËRMJET QEVERISË SË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS SË ARGJENTINËS

Qeveria e Republikës së Shqipërisë dhe Qeveria e Republikës së Argjentinës, duke dëshiruar të konsolidojnë dhe forcojnë më shumë marrëdhëniet miqësore ndërmjet dy shteteve dhe të interesuara për të zhvilluar bashkëpunimin shkencor dhe teknik me përfitim reciprok,
ranë dakord si më poshtë:

Neni 1

Palët angazhohen për të nxitur dhe lehtësuar zhvillimin e bashkëpunimit shkencor dhe teknik.

Neni 2

Format dhe kushtet e bashkëpunimit, të cilave u referohet kjo Marrëveshje, do të vendosen me marrëveshje të veçanta, për të cilat do të bihet dakord nëpërmjet kanaleve diplomatike.

Neni 3

Bashkëpunimi shkencor dhe teknik, i vendosur në këtë Marrëveshje, do të përfshijë, në mënyrë të veçantë, si vijon:

1. Shkëmbimin e ekspertëve, shkencëtarëve dhe misioneve teknike, si edhe aftësimin e personelit shkencor dhe teknik, të disiplinave të ndryshme.
2. Dhënien e bursave të specializimit dhe aftësimit, sipas modaliteteve, që do të rregullohen me marrëveshje reciproke.

3. Realizimin e përbashkët, nëpërmjet marrëveshjeve reciproke, të projekteve teknike dhe shkencore të hartuara dhe të propozuara nga institucionet kombëtare, publike ose private të të dy vendeve.

4. Çdo aktivitet tjetër të bashkëpunimit shkencor dhe teknik që Palët do të bien dakord ose do të vendosin me marrëveshje të veçanta të parashikuara në nenin 2.

Neni 4

Me qëllimin për të siguruar një zhvillim sistematik dhe të rregullt të bashkëpunimit, që i referohet kjo Marrëveshje, Palët angazhohen që:

1. Të hartojnë, qoftë në mënyrë direkte apo nëpërmjet enteve, apo institucioneve të caktuara nga Palët, programin e përgjithshëm të bashkëpunimit shkencor dhe teknik mes dy shteteve dhe të marrin masat e nevojshme për të siguruar realizimin e projekteve.

2. Të hartojnë, direkt apo nëpërmjet enteve, ose institucioneve të caktuara nga Palët, programet dhe projektet teknike që marrin parasysh përparësitë kombëtare të vendosura nga secila Palë.

Neni 5

Palët, bazuar në legjislacionet përkatëse të tyre në fuqi, mund të nxisin pjesëmarrjen e organizatave dhe institucioneve private në aktivitetet e bashkëpunimit të parashikuara në marrëveshjet e veçanta të përmendura më lart.

Neni 6

Palët do të ngrenë një komision miks, të përbërë nga përfaqësuesit që ato do të caktojnë, i cili do të mblidhet çdo dy vjet në mënyrë alternative në territorin e secilës Palë.

Funksionet e tij do të jenë:

1. ta vërë në zbatim këtë Marrëveshje;

2. të propozojë, të instruktojë dhe të vlerësojë aktivitetet specifike të bashkëpunimit, të cilave u referohet ky instrument;

3. të propozojë modifikimet që sheh të nevojshme për të arritur objektivat e kësaj Marrëveshjeje.

Neni 7

Në përputhje me këtë Marrëveshje, shpenzimet e dërgimit të ekspertëve, pajisjeve apo materialeve nga një vend në tjetrin do të jenë në ngarkim të Palës që i dërgon, kurse shpenzimet e qëndrimit, asistencës mjekësore dhe transportit lokal do të jenë në ngarkim të vendit pritës, gjithmonë kur të mos jetë vendosur tjetër procedurë në marrëveshjet specifike të parashikuara në këtë Marrëveshje.

Neni 8

Rregullat që lidhen me lehtësirat e funksionarëve dhe ekspertëve të Kombeve të Bashkuara do të zbatohen për funksionarët dhe ekspertët e secilës Palë Kontraktuese, që nuk janë shtetas apo rezidentë të përhershëm në territorin e Palës tjetër Kontraktuese të caktuar për të punuar në territorin e Palës tjetër Kontraktuese.

Neni 9

Palët do të marrin masat e nevojshme, në përputhje me legjislacionin në fuqi në territoret përkatëse të tyre, për të lehtësuar hyrjen, qëndrimin dhe largimin e ekspertëve që kryejnë funksione në kuadrin e kësaj Marrëveshjeje, si dhe të anëtarëve të familjeve të tyre. Në të njëjtën mënyrë do t'u krijojnë lehtësitë e nevojshme për kryerjen e funksioneve të tyre.

Pajisjet personale të ekspertëve dhe anëtarëve të familjeve të tyre dhe të pajisjeve apo

materialeve të importuara dhe/ose të eksportuara në kuadrin e kësaj Marrëveshjeje, do të jenë të përjashtuara nga pagesa e taksave dhe detyrimeve të tjera, në përputhje me legjislacionin kombëtar përkatës dhe duke marrë në konsideratë reciprocitetin e nevojshëm.

Neni 10

Këto rregulla do të hyjnë në fuqi tridhjetë ditë pas datës që Palët Kontraktuese të jenë informuar me shkrim mes tyre, në rrugë diplomatike, për përmbushjen e kritereve përkatëse kushtetuese.

Neni 11

1. Kjo Marrëveshje duhet të ratifikohet dhe do të hyjë në fuqi datën që do të realizohet shkëmbimi i instrumenteve përkatëse të ratifikimit.

2. Do të qëndrojë në fuqi për pesë (5) vjet, e rinovueshme automatikisht për periudha të njëjta kohe, vetëm në rast se njëra prej Palëve do të shprehë vendimin e saj për ta denoncuar në rrugë diplomatike dhe gjashtë (6) muaj para përfundimit të secilës periudhë.

3. Përfundimi i kësaj Marrëveshjeje nuk do të ndikojë në realizimin e projekteve dhe programeve në proces të vendosura në marrëveshjet e veçanta, vetëm në rast të një marrëveshjeje të kundërt nga Palët.

E nënshkruar në Tiranë, më 19 korrik 2007, në dy kopje origjinale, në shqip dhe spanjisht, që të dyja autentikisht të njëjta.